



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

Vendim

Nr. 3, datë 13 / 02 2012

“Për fillimin e procedurave për dhënien me qira të truallit me sipërfaqe prej 205 m<sup>2</sup> të ndodhur në Lgj.14, Rr. “Partizani”

Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe mbështetur në nenin 32 pika e) , e Ligjit 8562 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ku shprehet se Këshilli Bashkiak vendos për tjetërsimin ose për dhënien në përdorim të pronave të Bashkisë të tretëve” , V.K.M-së nr.529 datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe V.K.M-së Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, qarkut Korçë” si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për dhënien me qira, me anë të konkurimit të truallit me sipërfaqe 205 m<sup>2</sup> të ndodhur në Lgj.14, Rr. “Partizani”, për veprimtari ekonomike. Subjekti që do të shpallet fitues pas procedurës së konkurimit duhet të ruajë distancën prej 10 m nga rruga , për brez gjelberimi.
2. Afati për dhënien me qira të truallit do të jetë 3 vjet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Përgjegjësi i Rregjistrimit të pronave Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Illirjan PENDAVINJI